



BULETIN MUJOR

QERSHOR 2026

Forcimi i Qëndrueshmërisë Kibernetike Kombëtare

16 QERSHOR 2026

PËRMBAJTJA

- AKSK diskuton prioritetet me Infrastrukturat Kritike dhe të Rëndësishme të Informacionit
- Përmbillet me sukses fazën e dytë të përzgjedhjes për ECSC 2026
- Nis Programi Kombëtar për Ndërtimin e Kapaciteteve të Sigurisë Kibernetike për SME-të
- AKSK përmbyll ciklin e trajnimeve teknike për institucionet e pavarura
- Shqipëria vlerësohet për progresin në sigurinë kibernetike në Paris Cyber Summit 2026

AKSK diskuton prioritetet me Infrastrukturat Kritike dhe të Rëndësishme të Informacionit



Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike zhvilloi një takim me përfaqësues të Infrastrukturave Kritike dhe të Rëndësishme të Informacionit, me fokus forcimin e qëndrueshmërisë kibernetike dhe koordinimin ndërinstitucional.

Gjatë takimit u prezantuan prioritetet e AKSK-së për periudhën në vijim, duke përfshirë ngritjen e CSIRT-eve sektoriale, rritjen e kapaciteteve monitoruese, si dhe mbështetjen e vazhdueshme përmes auditimeve, testimeve të sigurisë dhe programeve të zhvillimit të kapaciteteve.

Aktiviteti shërbeu si një platformë dialogu për forcimin e bashkëpunimit dhe rritjen e nivelit të sigurisë kibernetike në vend.

Përmbillet me sukses fazën e dytë të përzgjedhjes për ECSC 2026

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike përfundoi me sukses fazën e dytë të procesit të përzgjedhjes së ekipit kombëtar që do të përfaqësojë Shqipërinë në European Cybersecurity Challenge (ECSC) 2026. Gjatë dy ditëve të selektimit, rreth 25 studentë dhe të rinj testuan aftësitë e tyre në sfida praktike Capture The Flag (CTF), në fusha si web security, cryptography, digital forensics dhe reverse engineering.

Në përfundim të procesit u përzgjedhën 10 kandidatët më të mirë, të cilët do të përfaqësojnë Shqipërinë në finalen evropiane të ECSC 2026, që do të zhvillohet në Bochum, Gjermani. Aktiviteti dëshmon angazhimin e AKSK për zhvillimin e talenteve të reja dhe forcimin e kapaciteteve kombëtare në fushën e sigurisë kibernetike.



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I Tiranë



www.aksk.gov.al



@aksk.gov.al



+355 422 21 039

Nis Programi Kombëtar për Ndërtimin e Kapaciteteve të Sigurisë Kibernetike për SME-të

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike zhvilloi trajnimin e parë me përfaqësues të Sipërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (SME), në kuadër të Programit Kombëtar për Ndërtimin e Kapaciteteve të Sigurisë Kibernetike për SME-të.

Gjatë aktivitetit, pjesëmarrësit u njohën me konceptet bazë të qeverisjes së sigurisë kibernetike, menaxhimin e riskut, kontrollet mbrojtëse, praktikatat e higjienës kibernetike dhe procesin e vlerësimit të maturitetit kibernetik.

Programi synon të forcojë kapacitetet e SME-ve për ndërtimin e proceseve dhe praktikave më të sigurta, duke rritur mbrojtjen e sistemeve, të dhënave dhe shërbimeve të tyre.



AKSK përmbyll ciklin e trajnimeve teknike për institucionet e pavarura

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike përmbylli ciklin e trajnimeve teknike për përfaqësuesit e institucioneve të pavarura, me fokus në sistemet SIEM (Security Information and Event Management), menaxhimin e log-eve, Endpoint Detection & Response (EDR) dhe mbrojtjen e pajisjeve fundore nga kërcënimet kibernetike.

Gjatë sesioneve teorike dhe praktike, pjesëmarrësit u njohën me teknika dhe mjete për monitorimin e ngjarjeve të sigurisë, analizimin e log-eve, zbulimin e aktiviteteve të dyshimta dhe reagimin ndaj incidenteve kibernetike.

Me përmbylljen e këtij cikli, AKSK vijon të forcojë kapacitetet profesionale të institucioneve, duke kontribuar në rritjen e qëndrueshmërisë kibernetike në nivel kombëtar.



Shqipëria vlerësohet për progresin në sigurinë kibernetike në Paris Cyber Summit 2026

Shqipëria mori vlerësime të veçanta për progresin e arritur në fushën e sigurisë kibernetike gjatë Paris Cyber Summit 2026, ku AKSK u përfaqësua nga Drejtori i Përgjithshëm, Bledar Kazia. Gjatë samitit u theksua roli i Shqipërisë si një nga vendet e para në Evropë që ka transpozuar plotësisht Direktivën NIS2 në legjislacionin kombëtar, si dhe përparimi në forcimin e kapaciteteve operacionale dhe mbrojtjen e infrastrukturave kritike.

Në kuadër të aktivitetit u zhvilluan gjithashtu takime dypalëshe me partnerë ndërkombëtarë, përfshirë CISA dhe ACN, me fokus zgjerimin e bashkëpunimit strategjik dhe operacional në fushën e sigurisë kibernetike. Samiti shërbeu si një platformë për shkëmbimin e praktikave më të mira dhe forcimin e partneriteteve ndërkombëtare për rritjen e qëndrueshmërisë kibernetike.

